



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ZËVENDËSKRYETARI

Nr. 2514/3 Prot.

Tiranë, më 18.02 2026

URDHËR

Nr. 42, Datë 18.02.2026

**“PËR MIRATIMIN E FORMULARIT STANDARD TË SINJALIZIMIT TË
BRENDSHËM/JASHTËM”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe me qëllim garantimin e procedurave të qarta dhe standarde për administrimin e sinjalizimeve pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,

URDHËROJ:

1. Miratohen Formularët Standard të Sinjalizimit të Brendshëm dhe të Jashtëm pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Formularët përdoren për:
 - a) Paraqitjen dhe regjistrimin e sinjalizimeve pranë kanalit të brendshëm;
 - b) Administrimin dhe dokumentimin e informacionit nga Njësia Përgjegjëse;
 - c) Garantimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe trajtimin procedural të sinjalizimit, sipas ligjit dhe rregullores përkatëse.


Formulari përmban, ndër të tjera, këto seksione:

- Të dhënat e sinjalizuesit (me mundësi paraqitjeje anonime);
- Përshkrimin e fakteve dhe rrethanave të raportuara;
- Dokumentacionin mbështetës (nëse ka);
- Çdo informacion tjetër të dobishëm për shqyrtimin e sinjalizimit;
- Seksionin për përdorim nga administrata (numër regjistrimi, data e marrjes, afati i shqyrtimit).

3. Përdorimi i formularit nuk është kusht për vlefshmërinë e sinjalizimit. Sinjalizimet e paraqitura në forma të tjera trajtohen në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 dhe rregulloren përkatëse.
4. Njësia Përgjegjëse përdor formularin si dokument standard për regjistrimin dhe administrimin e sinjalizimeve.
5. Ky urdhër hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe u njoftohet të gjithë punonjësve të gjykatës për zbatim. Formulari publikohet në ambientet dhe faqen zyrtare të gjykatës.

ZËVENDËSKRYETARI

ILIBA BEZATI



FORMULAR STANDARD I SINJALIZIMIT TË JASHTËM
“TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI”

DREJTUAR: Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në zbatim të ligjit nr. 96/2025

“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën:
_____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____,
paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

Paraqes këtë sinjalizim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , për arsye se :

1- _____ nuk ka Njësi përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 96/2025.

dhe paraqes sinjalizimin si më poshtë:

2- Njësia përgjegjëse në _____ për sinjalizimin e paraqitur më datë _____
(bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë), pranë njësisë;

☐ nuk filloi hetimin administrativ ose e përfundoi atë në kundërshtim me ligjin nr. 96/2025.

☐ zoti/zonja _____ që pret sinjalizimin ose zoti/zonja _____ janë përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë personal ose material me objektin e sinjalizimit sepse _____

☐ Dyshoj në integritetin dhe paanshmërinë e Njësisë përgjegjëse për shkak sepse _____

☐ Prova _____ e këtij sinjalizimi që gjendet në _____ fshihet apo shkatërohet nga _____

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden _____

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më / ____ / ____, në _____ nga _____, nga specialisti, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sinjalizuesi Specialisti
Emër Mbiemër Emër Mbiemër

FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BREND SHËM
“TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI”

DREJTUAR: Njësia Përgjegjëse të caktuar në zbatim të ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____, paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden _____

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (*nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.*)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më /___/___, në _____ nga _____, punonjës i Njesisë përgjegjëse në _____.

Sinjalizuesi Njësia përgjegjëse

Emër Mbiemër 1-Emër Mbiemër